

▪ Takim i Hapur: FASTIP-Kompani-Studentë

Më 27 Tetor 2010 në ambjentet e sallës së mbledhjes në FASTIP u organizua një takim i hapur mes Biznesit privat ku morën pjesë kryesisht kompani hoteliere dhe sipërmarrje të vogla dhe të mesme të cilat diskutuan rreth modelit FASTIP me studentë të këtij fakulteti dhe të rinjve që aspirojnë një vend pune të sigurt që në fillimet e studimeve të larta.

Dekani i FASTIP-it, Doc.Vladimir Muka mbajti fjalën e hapjes së këtij takimi dhe më tej koordinatorët e programeve të studimit prezantuan filozofinë e funksionimit të FASTIP-it. Kancelari i FASTIP-it, z.Mentor Isufaj bëri të njohur para të pranishmëve shembuj konkretë bashkëpunimi të arritura mes FASTIP-it dhe partnerëve të tij. Pjesëmarrësit, gjithashtu, u njohën edhe me mbështetjen gjermane që ka patur FASTIP-i.

Më tej përfaqësues të Bankave dhanë përshtypjet e tyre përsa i përkët bashkëpunimit të deritanishëm. Në fund të takimit u zhvillua një diskutim i hapur mes palëve të pranishme.